

Nr i prokurimit 624-020-007-521 / 624-020-467-521

Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Bujqësi dhe Pylltari- Gjinoc, Reqan, Sllapuzhan



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKË

07.05.2020

REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NË DORËZIM - PRIMLJENO RECEIVED			
Nësa org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shifra Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	351	17362	2

KOMUNA SUHAREKË, të cilën e përfaqëson Mustafë Buzhala, zyrtar i zyrës së Prokurimit dhe menaxheri i kontratës i caktuar me Aktvendim nga ZKA në PMK 1 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

N.N.T. " Etniku ", Samadrexhe, 23060, me seli në Suharekë, me NUI: 811036294 të cilën e përfaqëson Tahir Bugari (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Titulli i kontratës :

Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Bujqësi dhe pylltari- Gjinoc, Reqan, Sllapuzhan
Nr i prokurimit 624-020-007-521 / 624-19-467-521

Neni 1 Lënda

Lëndë e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Bujqësi dhe pylltari- Gjinoc, Reqan, Sllapuzhan**, specifikimeve teknike të dosjes së tenderit.

- 1.1 Punët duhet të përfundojnë sipas dinamikës së përcaktuar nga njësia e kërkesës, me se largu brenda 60 ditë pune dhe sipas dinamikës së përcaktuar nga menaxheri i projektit në PMK.
- 1.2 Operatori ekonomik para nënshkrimit të kontratës duhet të sjell sigurimin e ekzekutimit 10% të vlerës së kontratës për një periudhë prej: 90 ditësh.
- 1.3 E.O është i obliguar të bashkëpunojë me menaxherin e kontratës të Autoritetit Kontraktues dhe zyrën e prokurimit. OE është i obliguar të njoftoj zyrën e prokurimit dhe menaxherin e projektit, nëse projekti kapital nuk është duke u realizuar konformë kontratës dhe specifikimeve dhe paramanave të dhëna me kontratë.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 45.660,00 € (Katerëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë euro).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesën në euro, sipas faturave të dorëzuara së bashku me raportin e nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe menaxheri i kontratës, në llogarinë bankare të OE.

2.5 Pagesa e fundit në vlerë jo më pak se 10% vlerës së kontratës do të bëhet me raportin e mbikëqyrësit dhe menaxherit të projektit dhe raportin e pranimi teknik nga komisioni përkatës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

¹ PMK Plani Menaxhimit të Kontrates

- 3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
- (a) Marrëveshja e kontratës;
 - (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
 - (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
 - (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
 - (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

4.5 Numri kontaktues i OE është 049/257427

Email: nntetniku@gmail.com

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Mustafë Buzhala
Pozita:	Zyrtar i zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	07/05/2020
Vula	vv

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Tahir Bugari
Pozita:	Përfaqësues
Nënshkrimi	
Data	07/05/2020
Vula	vv



² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Ndërtimi i infrastruktures rrugore në Bujqësi dhe pylltari- Gjinoc, Reqan, Sllapuzhan Nr i prokurimit 624-020-007-521 / 624-19-467-521
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 90 ditësh .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i

		pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 3 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 3 dite pas nënshkrimit të kontratës, nese nuk specifikohet ndryshe ne PKM.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 60 ditë pune, ndersa me PMK munde te shkurtohet ky afat nese palet pajtohen.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është caktuar me Vendim të ZKA-së
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës (me sigurim ekzekutimi).
Vërtetimet e pagesë	28	28.1 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit. 28.2. Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë pas pranimit teknik.
Pagesa shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e

		dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore mosmarrëveshje ve	42.2	ZP Komuna Suhareke ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja mosmarrëveshje ve me procedurë gjqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Për:	ZYREN E PROKURIMIT KOMUNA SUHAREKË
Nga:	N.N.T. " Etniku ", Samadrexhe, 23060, Suharekë
Lënda:	DEKLERATË PER KUALITETIN E PUNIMEVE
Datë:	07/05/2020

I/e nderuar,

Kjo deklaratë bëhet në pajtim me Kontratën:

Titulli i kontratës

Ndërtimi i infrastruktures rrugore në Bujqësi dhe pylltari- Gjinoc, Reqan, Sllapuzhan
Nr i prokurimit 624-020-007-521 / 624-19-467-521

Për të përmbushur obligimet që dalin nga neni 27 pika 1 dhe 34.5 (KVK) e kontratës së lartcekur.

Ne konfirmojmë se:

Ne si Operator Ekonomik pas pranimit teknik ofrojmë garancion të rregullt 1 vjeçar, duke siguruar garancion prej 10 % nga vlera e kontratës, si dhe deklarojmë mbi cilësinë e punës dhe mallrave në kohëzgjatje 1 vjet nga dita e pranimit teknik dhe obligohemi dhe pranojmë se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do t'i sanojmë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të kundërtën ne pajtohemi se AK ato dëme do t'i sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do të na faturojë ne si Kontraktor që kemi dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve.

Me respekt:

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit : John Sogun Nënshkrimi KSogun

DATA: 07/05/2020



PARAMSA DHE PARALOGARIA PËR RREGULLIMIN E RRUGËVE FUSHORE						
L= 12000 m.						
Punët Parapregaditore						
1						
		Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total	
1.1	Shënimi, piketimi i rrugëve matje gjeodezike - sipas matjeve kadastrale të trases së rrugës fushore	m	12,000.00	0.05	600.00	
2	Punët Demoluese					
2.1	Pastrimi i terentit nga mbeturinat, e ngurta shkurret drurje dhe rrethqajave në zonat ku do të kalojë traseja e rrugës. Pastrimi i tyre bëhet normal me drejtimin e rrugës me gjerësi të përcaktuar b=6m sipas profilit tërthorë si dhe largimin e tyre në depotin Deponimin e materialit të demtuar e caktim Investitorit. Llog. në m²	Njësi				
2.2	Punët Tokësore	m2	60,000.00	0.05	3,000.00	
3.1	Gërmimi dhe largimi i dheut kategorisë III-IV, deri në thellësinë dhe me gjerësi b=5-6cm, të nevojshme për punë duke përfshirë të gjitha pikat gjeodezike .	m2	60,000.00	0.10	6,000.00	
3.2	Punimi i kanalit të hapur anësor për largimin e ujërave atmosferik në formë trapezi në të njëjtë anë të rrugës .	m'	12,000.00	0.10	1,200.00	
3.3	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugës (paja mbushjes) me rrafshim dhe ngjeshje, si dhe rregullimi i pjerrtësisë tërthore dhe gjatësore të rrugëve	m2	60,000.00	0.05	3,000.00	
3.4	Mbushje për nivelizimin e trasës së rrugës nga dheu I gërmuar I kategorisë III dhe IV me ngarkim dhe barje nëpër trasë me shtirje dhe ngjeshje me cilindër vibrues në shtresa deri 20 cm , për nivelizimin e trasës së rrugës.	m2	60,000.00	0.05	3,000.00	
4	Pjesa sipërfaqësore (Mbushja) e rrugës					
4.1	Furnizimi, transporti, shtirja dhe punimi i shtresës së bazës së rrugëve nga guri natyral, aty ku është e nevojshme si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues .	m3	500.00	1.00	500.00	
4.2	Furnizimi, transporti, shtirja dhe punimi i shtresës së rrugëve me zhavor nga gurit të thyer fraksion 0-63 mm, me trashësi të shtresës t=15 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mw=400 kg/cm2 . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.	m3	9,000.00	3.00	27,000.00	
5	Punimet e lëshesave (Tombinave)					
5.1	Furnizimi , transporti dhe vendosja e lëshesave (tombinave) rrethore prej gypave Ø500 të parapregaditura nga betoni . Kokat hyrëse dhe dalje të lëshesave të pregaditen dhe punchen nga kalapej prej drasave BA betoni C25/30 .	m	100.00	10.00	1,000.00	
6	hapja e kanaleve horizontale dhe vendosja e gypave-fl-500 në proekat sipas nevojës bager me fuqi 5-16 T	orë	12.00	30.00	360.00	
TOTALI :					45,660.00	

DORËZUAR NGA:

EMRI I KOMPANISË	IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK
ADRESA E PRËKËTË	NNI ETNIRK
PRËKËTË	SAMADIAKH-SUHARETE
EMRI	IAHIR BUDAREI
POSITA	DEPTOR
NE VENDORIA	25.08.2024
DATA	
SHÏLA	